

## SHTETI I PA MBIKËQYRUR

### PËRBRENDIA I NDARË, NDËRKOMBËTARISHT GJYSMË-LEGJITIM

Përgatitur nga:

**Illir Deda dhe  
Shpend Kursani**

#### HYRJE

Në mbledhjen e pesëmbëdhjetë të mbajtur më 2 korrik 2012, Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) ka bërë të ditur synimin e vet për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, diku kah mesi i shtatorit të 2012-ës. Në këtë takim, GDN-ja ka përgëzuar Qeverinë e Kosovës (QeK) për “mbështetjen e saj të qartë për një shtet demokratik dhe shumetnik, siç është dëshmuar me miratimin e ligjeve dhe të amendamenteve për zbatimin e pakos së Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit (PGJS), përfshirë këtu ligjet për trashëgiminë kulturore dhe atë fetare, të drejtat e komuniteteve dhe decentralizimin”.<sup>1</sup> Sa i përket veriut të Kosovës, GDN-ja ka vlerësuar dhe mirëpritur vendimin e QeK-së për hapjen e Zyrës administrative për Mitrovicën Veriore (ZAMV) dhe qëllimin e Kryeministrit për të thelluar angazhimin me komunitetin serb atje. Në lidhje me fuqizimin e legjitimitetit ndërkombëtar të shtetit të ri, GDN-ja është zotuar që të vazhdoj të mbështes “kërkesën” e Kosovës për njohje të mëtutjeshme ndërkombëtare dhe “aspiratën” e saj drejt anëtarësimit në organizatat relevante ndërkombëtare. Në fakt, janë disa suksese në zbatimin e dispozitave të PGJS-së, sikurse që është krijimi i komunave të reja me shumicë serbe, decentralizimi, mbrojtja e trashëgimisë fetare dhe kulturore, miratimi i simboleve kombëtare, flamurit dhe himnit, duke reflektuar karakterin shumetnik, themelimi i Policisë shumetnike të Kosovës (PK), dhe përfshirja graduale e komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike.

Pas më shumë se katër vitesh nga deklarimi i pavarësisë, afër 90 shtete e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur, e cila po ashtu ka arritur që të bëhet anëtare e vetëm dy institucioneve ndërkombëtare—Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar. Kështu që është shumë afër mendsh se përmbyllja zyrtare e pavarësisë së mbikëqyrur do të festohet. Njerëzve në Kosovë sikurse edhe atyre jashtë vendit do t'u tregohen për "të arriturat e mëdha" të shtetit të ri dhe të mbikëqyrësve të saj ndërkombëtar.

Kjo festë, megjithatë, do të shmang problemet e vërteta të Kosovës: ajo mbetet e ndarë përbrenda dhe me legjitimitet të kufizuar në arenën ndërkombëtare. Pos kësaj, në përgjithësi ka mangësi në zbatimin e legjislacionit të aprovuar, Kosova ka probleme të thella sa i përket funksionimit themelor demokratik. Pjesa veriore mbetet de-facto e ndarë, një situatë kjo që rrezikon të minoj të gjitha sukseset e arritura në jug të vendit. Siguria e shtetit dhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të vazhdoj që t'i besohet trupave, mandatet e të cilave burojnë nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999), përkatësisht KFOR-i dhe EULEX-i. Personeli ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) do të mbetet akoma i pranishëm në institucionet më të rëndësishme publike të shtetit. Së fundi, për shkak të mungesës së përkushtimit nga ana e sponsorëve të pavarësisë së mbikëqyrur, legjitimiteti ndërkombëtar i Kosovës po mbështetet gjithnjë e më shumë në Serbinë dhe në "normalizimin e marrëdhënieve" me Beogradin, sesa të mbikëqyrësit e saj ndërkombëtarë, të cilët ishin përgjegjës për këtë. Në aspektin strategjik, Kosovës po i mungon perspektiva për t'u futur në programin e "Partneritetit për Paqe" të NATO-së dhe mbetet pa marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian (BE) - nga të cilat varen jo vetëm reformat, por po ashtu edhe siguria dhe stabiliteti i vendit.

## MITI I QEVERISJES DEMOKRATIKE

Kosova ka njërën prej Kushtetutave më të avancuara në rajon, e cila është miratuar në qershor të vitit 2008. Ajo përfshin parimet kryesore të PGJS-së dhe në të njëjtën kohë ofron një platformë të qëndrueshme për një shtet të lirë, të hapur, demokratik dhe shumetnik. Kuvendi i Kosovës ka miratuar më shumë se 300 ligje në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i një shoqërie demokratike.<sup>2</sup> Në të vërtetë, ende ka probleme domethënëse sa i përket zbatimit të këtyre instrumenteve ligjore, të cilat si rezultat e lënë Kosovën me probleme elementare të funksionimit të saj demokratik dhe pavarësisë institucionale.

E para, Kosova përballet me probleme të mëdha në njërin prej elementëve fundamental të demokracisë – zgjedhje të lira dhe të drejta. Zgjedhjet e fundit të mbajtura më 12 dhjetor 2010, janë një shembull i zymtë i degradimit të tërësishëm të praktikës demokratike që Kosova e ka hasur nga viti 1999. Ndërmjet dyzet deri në gjashtëdhjetë për qind të votave janë raportuar të jenë manipuluar, duke çuar në rinumërim të parregullt të gjithë 40 për qind të fletë votimeve.<sup>3</sup> Përkundër asaj që ka qenë e njohur si "vjedhje industriale e votave" nga ana e diplomatëve të ndryshëm të pranishëm në Kosovë, në fund rezultati i zgjedhjeve përgjithësisht është pranuar dhe miratuar nga diplomatët kryesorë perëndimor dhe zyrtarët e lartë. Zëvendës Presidentja e Komisionit Evropian dhe Përfaqësuesja e Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri e BE-së, Catherine Ashton, dhe Komisionari për Zgjerim, Štefan

<sup>1</sup> GDN, Komunikata e 2 qershorit, (Vjenë: 2012), <http://tinyurl.com/bv5v7n5>.

<sup>2</sup> Rep. e Kosovës, Ligjet e Publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, (Prishtinë: 2012),

<sup>3</sup> Komisioni Evr., Dokument Pune i Personelit të Komisionit: Raporti i Progresit 2011 për Kosovën\*, (Bruksel: 2011),

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_document\\_s/2011/package/ks\\_rapport\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_document_s/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf). Për më tepër, ri-zgjedhjet janë mbajtur në 3 komuna dhe në 2 qendra të votimit (20% të elektoratit) me qëllim të krijimit të përshtypjes se janë ndërmarrë hapa për të adresuar manipulimet.

Füle menjëherë kanë uruar “popullin e Kosovës për zgjedhjet [...] dhe për mënyrën e qetë dhe të rregullt në të cilën pjesa më e madhe e votimeve është zhvilluar.”<sup>4</sup>

Këto praktika të mangëta demokratike, që nuk janë kundërshtuar apo refuzuar nga "mbikëqyrësit ndërkombëtarë", e të cilët në bazë të PGJS-së kanë pushtet ekzekutiv për ta bërë këtë, kanë rezultuar me krijimin e një qeverie me legjitimitet të kontestuar gjatë tërë mandatit. Kryesit e përfshirë në këto mashtrime zgjedhore nuk janë hetuar në mënyrë të duhur nga autoritetet lokale të sundimit të ligjit e as nga EULEX-i.<sup>5</sup> Ndjekja e tyre nuk është bërë në mënyrë të duhur dhe ndjekja e gabuar e të akuzuarve gjithashtu ka çuar te krijimi i perceptimit të mosndëshkimit të manipuluesve dhe të atyre që janë përfshirë në këto veprime. Trajtimi pa kujdes i mashtrimit zgjedhor gjithashtu ka ndikuar në zvogëlimin e besimit të njerëzve në vlerën e zgjedhjeve si mjet për të sjellë ndryshime.

Mos veprimi i mbikëqyrësve ndërkombëtarë kundruall shkeljeve të tilla të drejtave të njeriut gjatë zgjedhjeve, gjithashtu ka kontribuar në krijimin e perceptimit publik se ekziston një partneritet i fuqishëm ndërmjet elitës politike jo-legjitime vendore në pushtet dhe hisedarëve ndërkombëtarë. Ky “partneritet vendor-ndërkombëtar” është parë si i paprekshëm dhe i pandryshueshëm nga instrumentet standarde demokratike, sikurse edhe imun ndaj llogaridhënies. Ky “partneritet vendor-ndërkombëtar” i krijuar pas zgjedhjeve të pranuar gjerësisht si të manipuluar e ka lënë shoqërinë e Kosovës që të besoj se demokracia është një mit dhe se do të vazhdoj që të jetë e

tillë. Gjithashtu ka dobësuar zotësinë e njerëzve që të kërkojnë llogari nga të zgjedhurit, pasi që gjithashtu është krijuar perceptimi se “partneriteti vendor-ndërkombëtar” i pathyeshëm paraqet elitën që vendos përfundimisht.

Një zgjidhje politike për këto probleme ishte ofruar në prill të 2011-ës, përmes një marrëveshjeje për reformën zgjedhore ndërmjet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Kosovën e Re (AKR). Kjo marrëveshje, e cila u bë rezolutë e detyrueshme në Kuvendin e Kosovës, parashihte ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjen e presidentit, dhe bënte thirrje për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale në vitin 2012 dhe të zgjedhjeve të përgjithshme dhe lokale në vitin 2013. Sidoqoftë, kjo rezolutë nuk është respektuar. Grupet punuese për reformën zgjedhore nuk kanë prodhuar rezultate, duke cenuar edhe një proces tjetër që kishte për synim zgjidhjen e të metave më të mëdha zgjedhore.

Një tjetër e metë e madhe demokratike mund të vërehet në rolin dhe punën e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi, i cili ka një legjitimitet thellësisht të kontestuar, vazhdimisht është i anashkaluar dhe tejet i manipuluar. Nuk ka arritur që të krijoj ndonjë rezultat në sistemin e shtetit të ri për kontroll dhe baraspeshë. Por më shumë është shndërruar në një objekt të “partneritetit vendor-ndërkombëtar” sesa në subjekt për diskutimin dhe miratimin e ligjeve të nevojshme dhe ratifikimin e rezolutave dhe vendimeve që i avancojnë interesat e shtetit bazuar në Kushtetutë. Janë disa shembuj që e ilustrojnë këtë. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka filluar pa autorizimin e platformës së dialogut të QeK-së nga Kuvendi. Ekzekutivi është autorizuar që të hyj në dialog vetëm pas përfundimit të raundit të parë. Përveç kësaj, Rezoluta<sup>6</sup>, e cila obligon zyrtarin e caktuar nga Kryeministri për udhëheqjen e bisedimeve

<sup>4</sup> Deklaratë e përbashkët nga Përfaqësuesja e Lartë e BE-së Catherine Ashton dhe Komisionari për zgjerim Štefan Füle mbi zgjedhjet e Kosovës, (Bruksel: Memo 2010).

<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/10/675&type=HTML>

<sup>5</sup> Më shumë se 1.300 njerëz janë akuzuar dhe më shumë se 900 pritet të akuzohen nga Prokuroria për përfshirjen e tyre në këto aktivitete manipuluese gjatë zgjedhjeve, si dhe përfshirjen e tyre në kërcënime dhe frikësime, shkatërrim të dokumenteve të votimit, dhe të ngjashme.

<sup>6</sup> Kuvendi i Rep. së Kosovës, Rezoluta e Kuvendit Nr. 04-R-001, Prishtinë, 10 mars 2011.

<http://tinyurl.com/caafv6t>.

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të informuar Komisionin për Punë të Jashtme dhe Komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës në baza të rregullta mbi përparimin e dialogut është shpërfillur nga ekzekutivi. Për më shumë, dy mocionet e Kuvendit, që kanë kërkuar nga QeK-ja që të aplikoj masa të reciprocitetit me Serbinë dhe të cilat kanë kushtëzuar dialogun me Serbinë me zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur së pari, janë interpretuar si rekomandime të thjeshta pa fuqi obligative.<sup>7</sup>

Shpërfillja e Kuvendit dhe rezolutave të tij nga ana e Ekzekutivit kur është fjala për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në mënyrë të heshtur mbështetet nga BE-ja dhe akterët tjerë perëndimorë. Madje ka raste kur ata shkojnë aq larg sa edhe inkurajojnë shpërfilljen e Kuvendit dhe praktikat tjera demokratike, pasi që dialogu jopopullor ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duket të jetë e vetmja shpresë e mbetur e perëndimit për të “ruajtur stabilitetin rajonal”. Ajo çka lë përshtypje këtu është se në mesin e të gjitha të metave demokratike të deklaruara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të 2011-ës në lidhje me punën e Kuvendit, i njëjti nuk arrin që t’i adresoj këto të meta<sup>8</sup> të rëndësishme demokratike të punës së Kuvendit. Kjo e vërteton edhe një herë “partneritetin vendor-ndërkombëtar”, i cili po i minon proceset themelore demokratike brenda shtetit edhe më fortë. Shkëmbimi i demokracisë për stabilitet mund të duket si qëllim i arsyeshëm afatshkurtër; megjithatë një shkëmbim i tillë dëmton aftësinë e shoqërisë për të përdorur proceset dhe instrumentet demokratike në respektim të Kushtetutës dhe avancimit, gjë që në aspektin afatgjatë do të ketë ndikim edhe më negativ në stabilitetin shtetëror dhe atë rajonal.

<sup>7</sup> Lumturie Blakaj, “Mocioni i plotfuqishëm”, Zëri, 23 maj, 2012, qasur më 23 korrik 2012, <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/49830/mocioni-i-plotfuqishem/>

<sup>8</sup> Meqë çështja me dy mocionet ka ndodhur në vitin 2012, mbetet për t’u parë nga Raporti i Progresit 2012 nëse kjo ka qenë apo jo një çështje për Komisionin e BE-së.

## PARADOKSI: PËRFUNDIMI GJATË VAZHDIMIT TË MBIKËQYRJES

Në frymën e PGJS-së, përfundimi eventual i pavarësisë së mbikëqyrrur do të ndodhë kur dhe pasi që PCN-ja të vlerësoj se autoritetet vendore janë të gatshme për të marrë përsipër përgjegjësitë nga anëtarët ndërkombëtarë të pranishëm në institucionet publike. Megjithatë, mbyllja e ZCN-së (ICO) nuk do të rezultojë me përfundimin e mandateve të të emëruarve ndërkombëtarë. Shumica e këtyre mandateve janë zgjatur deri më 2014-ën, duke lënë që të kuptohet se autoritetet vendore nuk janë gati që të kenë përgjegjësinë e plotë për udhëheqjen e institucioneve kyçe shtetërore dhe publike. Megjithatë, zgjatja e mandateve për personelin ndërkombëtar nuk do të thotë që shteti do të jetë në gjendje që të bëjë këtë edhe pas vitit 2014. Për më shumë, është shumë pak e besueshme se praktikrat aktuale të papërgjegjshme në disa prej këtyre institucioneve do të ndryshojnë në dy vitet e ardhshme, diçka që prania e ndërkombëtarëve në këto 4 vitet e kaluara nuk e ka siguruar.

Anëtarët ndërkombëtarë do të mbajnë pozitat e tyre në institucionet në vijim:

(1) *Gjykata Kushtetuese*: E përbërë nga 9 gjyqtarë, 3 prej tyre janë anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja.<sup>9</sup> Mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë është zgjatur me vendimin e PCN-së deri më 31 gusht 2014.

(2) *Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)*: I përbërë prej 13 gjyqtarëve, 2 prej të cilëve janë anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga PCN-ja, e të cilët do të vazhdojnë që të kenë pushtet edhe pas mbylljes së ZCN-së.

(3) *Gjykata Supreme, ato të Qarkut dhe gjykatat tjera*: PCN-ja mban autoritetin për të emëruar vetëm dy gjyqtarë ndërkombëtarë në Komisionin e Ankesave të Gjykatës Supreme.<sup>10</sup> Megjithatë PCN-ja me vendimin e tij në mars të 2010-ës,<sup>11</sup> dorëzoi autoritetin e tij me pëlqim për emërimet e ardhshme të gjykatësve dhe prokurorëve

<sup>9</sup> PGJS, Shtojca I, Neni 6.1.3

<sup>10</sup> PGJS, Shtojca VII, Neni 5.1

<sup>11</sup> ZCN, Vendimi Nr. 2010/36, <http://www.ico-kos.org/d/Decision%202010-36%20ENG.pdf>

ndërkombëtarë të zgjedhur nga EULEX-i. Duke marrë parasysh faktin se EULEX-i nuk vepron në kuadër të PGJS-së, që do të thotë se mandati i tij ekzekutiv për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk i nënshtrohet pëlqimit të PCN-së ashtu siç parashihet me PGJS-në, PCN-ja vendimin e marsit të 2010-ës e ka përshtatur me realitetin në terren.

(4) *Auditori i Përgjithshëm*: PCN-ja mban autoritetin për të emëruar Auditorin e Përgjithshëm<sup>12</sup>, i cili ishte emëruar në vitin 2009 për një mandat pesë vjeçar.

(5) *Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)*: I përbërë nga 8 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga PCN. PCN gjithashtu emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, një anëtar në secilin prej komisioneve të likuidimit dhe një anëtar, i cili po ashtu kryeson në secilin nga Komisionet Shqyrtuese. Pesë anëtarë tjerë të Bordit<sup>13</sup> emërohen nga Kuvendi i Kosovës. PCN-ja ka marrë vendim që të ri-emëroj dy nga tre anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të Drejtorëve pasi, siç thuhet në një vendim të dyshimtë nga ana e PCN-së, “vendimit të Qeverisë së Kosovës për të amendamentuar Kushtetutën për t’i lejuar të emëruarit nga PCN-ja që të sigurojnë ndihmë të mëtejshme teknike për institucionet e Kosovës pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur.”<sup>14</sup> Kjo në vetvete është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe vet PGJS-në, pasi që amendamentet në Kushtetutën e Kosovës bëhen nga 2/3 e votave të Kuvendit.<sup>15</sup> Qeveria vetë nuk mund ta ndryshojë Kushtetutën; ajo vetëm mund të propozoj ndryshimet ose amendamentet për Kushtetutën.<sup>16</sup>

(6) *Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP)*: I përbërë nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve, duke përfshirë edhe kryesuesin, janë të emëruar

nga PCN-ja.<sup>17</sup> PCN-ja gjithashtu emëron 2 anëtarë të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Dy anëtarët tjerë të Bordit Mbikëqyrës emërohen nga Kuvendi i Kosovës pas nominimit të bërë nga Kryeministri.

(7) *Bordi Udhëbeqës i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës*: I përbërë nga 8 anëtarë, 1 prej të cilëve emërohet nga PCN-ja, dhe shtatë të tjerë nga Kuvendi i Kosovës.

(8) *Komisioni i Pavarur për Shqyrtimin e Materialeve Mësimore në Gjuhën Serbe*: I përbërë nga 7 anëtarë, njëri prej të cilëve emërohet nga PCN-ja, tre nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe tre të tjerë nga deputetët serb të Kuvendit të Kosovës.

Janë edhe tre trupa që është dashur të krijohen bazuar në PGJS, por që asnjëherë nuk janë jetësuar. Ato janë: Këshilli për Zbatim dhe Monitorim, që do të duhej të ishte përgjegjës për monitorimin dhe lehtësimin e zbatimit të dispozitave të vet PGJS-së që lidhen me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë. Në vend të kësaj detyra e këtij trupi po kryhet nga kreu i Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë; (2) Komisioni i Pavarur për Universitetin e Mitrovicës së Veriut; dhe (3) Bordi i Përbashkët i komunave të Mitrovicës së Veriut dhe të Mitrovicës së Jugut.

## REZOLUTA E GJITHËPRANISHME 1244

Me mbylljen e ZCN-së, Prishtina do të humb trupin e vetëm ndërkombëtar të pranishëm në Kosovë që është pro-pavarësisë, që përndryshe do të duhej të ishte institucioni shumë-kombëtar që mbyllet i fundit. Në vend të kësaj në Kosovë do të mbeten misionet e UNMIK-ut, KFOR-it dhe të EULEX-it, të cilat do të vazhdojnë praninë e tyre me qëndrim neutral ndaj statusit. Kjo nënkupton se fushat më të rëndësishme të shtetit të ri do të mbeten nën “mbikëqyrje” të institucioneve që veprojnë në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, të cilat në të njëjtën kohë mohojnë ekzistencën e shtetit të ri. Fushat e rëndësishme sikur siguria e shtetit dhe

<sup>12</sup> PGJS, Shtojca IX, Neni 2.2a

<sup>13</sup> Rep. e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-034 mbi AKP-në, Neni 12.2

<sup>14</sup> ZCN, Letra e 29 qershorit 2012, që përmban vendimin Nr. 2012/07 dhe Nr. 2012/08

<sup>15</sup> PGJS, Shtojca I, Neni 10.1

<sup>16</sup> Kushtetuta e Rep. së Kosovës, Neni 144.1

<sup>17</sup> PGJS, Shtojca VII, Neni 4.2 dhe Kushtetuta e Rep. së Kosovës, Neni 144.2

lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të vazhdojnë që të mbështeten në këto trupa që janë neutrale kundruall statusit.

GDN-ja nuk ka arritur që të përmbush premtimin për krijimin e Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare (PUN) dhe të misionit evropian për sundim të ligjit në përputhje me PGJS-në, prej të cilave përgjegjësitë përfundimisht do të barteshin te autoritetet vendore me përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur.

Pavarësisht nga këto mangësi ligjore dhe praktike, GDN-ja ka inkurajuar Qeverinë dhe institucionet e Kosovës që të mbështesin vazhdimin e mandatit të EULEX-it, duke përfshirë edhe funksionet ekzekutive, mbi një “bazë të përshtatshme ligjore”.<sup>18</sup> Edhe kjo po ashtu është paradoksale, sepse derisa po përfundon mbikëqyrja e pavarësisë së Kosovës, GDN-ja po e inkurajon Kosovën që ta legalizoj mandatin e EULEX-it në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, e cila sipas zyrtarëve të Kosovës së pavarur besohet që është pjesë e të së “kaluarës”.

Kësisoj mbyllja e ZCN-së nuk do të përkthehet në përfundim dhe bartje të kompetencave nga misionet përkatëse ndërkombëtare ushtarake dhe të sundimit të ligjit te autoritetet e Kosovës, respektivisht te Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Qeveria e Kosovës, ashtu siç e parashihte PGJS-ja. Këto misione ndërkombëtare dhe fati i tyre përfundimtar do të vendosen pas ndryshimeve në Rezolutën 1244, që varet nga Rusia, vendimi përfundimtar i së cilës varet nga vullneti i Serbisë dhe qëndrimit të saj kundruall Kosovës.

## POZITA E PAKICAVE ETNIKE

Qeveria aktuale e Kosovës, për herë të parë, varet nga votat e partive të pakicave etnike, përfaqësuesit e të cilave vazhdimisht ankohen për pozitën e komuniteteve të tyre. Partitë e pakicave etnike nuk e kanë shfrytëzuar në tërësi këtë ngritje politike për të avancuar pozitën e tyre. Të gjitha grupet e pakicave etnike

posedojnë mjetet e duhura institucionale për mbrojtjen e të drejtave të tyre, dhe për të qenë lojtar më aktiv politik në Kosovë. Në vend të kësaj, ata mbeten të copëtuar dhe në grindje me rivalët e tyre politik.

Në këto rrethana, pakicat etnike mbeten të frikësuara nga klasa politike e shqiptarëve të Kosovës, të cilët i akuzojnë për pandjeshmëri kundruall nevojave të tyre. Me qëllim të adresimit të disa prej mangësive kyçe institucionale, QeK ka vendosur që të emëroj Komisionarin për Gjuhë, zyra e të cilit do të jetë përgjegjëse për sigurimin e zbatimit dhe të respektimit të plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Gjithashtu, nga mesi i shtatorit, Qeveria do të emëroj drejtorin e kanalit të dytë në gjuhën serbe të Radio Televizionit të Kosovës.

Njëri prej sukseseve më të mëdha të zbatimit të PGJS-së ka qenë decentralizimi, ku kanë përfituar pakicat; janë themeluar komunat e reja ku shumicë janë pakicat. Kjo ka ndihmuar pakicat që të marrin në duart e tyre qeverisjen në zonat e veta dhe menaxhimin e pjesës më të madhe të shërbimeve publike. Ata menaxhojnë arsimin, shëndetësinë, gjyqësorin, çështjet kulturore, dhe të ngjashme. Ka qenë ky decentralizim i suksesshëm që ka ofruar akomodim elementar të nevojave të dy të tretave të serbëve të Kosovës. Megjithatë, komuna e reja nuk e kanë arritur potencialin e tyre dhe në shumicën prej tyre ka qeverisje të plasaritur. Burimet kryesore financiare të tyre ende vijnë nga qeveria qendrore.

Gjithashtu, në vendbanimet me shumicë serbe në jug të lumit Ibër ende ka institucione paralele të mbështetura nga Beogradi dhe komuna paralele.<sup>19</sup> Këto institucione megjithatë nuk ndërhyjnë në punën e komunave legale – ato përqendrohen në arsim, shëndetësi, pagesat sociale dhe pensionet. Komunat paralele në jug të Ibrit më shumë shërbejnë si institucione për punësimin e serbëve të Kosovës sesa si sabotator të institucioneve të Kosovës.

<sup>18</sup> GDN, Komunikata e 2 qershorit, (Vjenë: 2012), <http://tinyurl.com/bv5v7n5>.

<sup>19</sup> Këto institucione paralele janë të pranishme dhe funksionojnë në 27 nga 38 komunat e Kosovës.

Punësimi që ofrohet nga këto komuna paralele është burim i rëndësishëm i të ardhurave për serbët e punësuar në këto komuna. Prandaj ndërprerja e punës së komunave paralele duhet të përcillet me një plan të detajuar për absorbimin dhe akomodimin e tyre.

Serbët e Kosovës do të duhet që të adresojnë problemin e tyre fundamental – atë të lidershit të dobët politik. Një numër i liderëve të serbëve të Kosovës në të gjithë Kosovën kanë filluar që të mendojnë për krijimin e një këshilli të përbashkët politik, autonom nga Beogradi, dhe me këtë unitet ti prezantojnë kërkesat para Prishtinës, Beogradit dhe pranisë ndërkombëtare.<sup>20</sup> Ata e shohin se serbët në jug të Ibrit do të vazhdojnë që të jenë të marginalizuar pa një zë të fuqishëm politik. Partia në pushtet e serbëve të Kosovës, Partia e Pavarur Liberale (SLS) ndodhet nën kritika të ashpra të të gjitha partive tjera politike serbe dhe të organizatave të shoqërisë civile që nuk ka qenë e aftë që të shfrytëzoj në tërësi institucionet për avancimin e interesave të serbëve të Kosovës.

Serbët ndjejnë se Kosova nuk është e gatshme për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyruar. Ata të gjithë kërkojnë një “adresë të vetme” kah mund të kthehen, duke marrë parasysh përkeqësimin e marrëdhënieve ndër-etnike në jug të Ibrit. Për më shumë, pozita e serbëve të Kosovës në jug të Ibrit në mënyrë vendimtare varet nga pozita e veriut, dhe mënyrës se si veriut do të mbetet në Kosovë.<sup>21</sup>

Komuniteti boshnjak mbetet i lidhur politikisht me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Si aleat politik, partitë boshnjake kanë arritur që ngadalë të shtyjnë avancimin gradual të statusit të tyre. Në bashkëpunim me ZCN-në, ata kanë arritur fillimin e studimit të fizibilitetit për krijimin e tri komunave të reja me shumicë boshnjake, që është akoma duke u zhvilluar.

<sup>20</sup> KIPRED intervista të shumta me liderët e serbëve të Kosovës, maj, qershor, dhe korrik 2012.

<sup>21</sup> Për më shumë informata, shih: Shpend Kursani dhe Ilir Deda, “Autonomia për pjesën veriore të Kosovës: Shpalosja e skenarëve dhe pasojat për rajonin”, KIPRED (2012). <http://tinyurl.com/ccsn5gh>.

Krijimin e këtyre komunave ata e shohin si siguri për zhvillimin e tyre lokal, posaçërisht për Prizrenit dhe Pejës. Për të arritur këtë ata do të kenë nevojë për mbështetje më të vendosur të pranisë ndërkombëtare. Ngjashëm, edhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) nuk kanë parë ndonjë dobi nga prania ndërkombëtare në Kosovë. Ata mbeten pakica e harruar, përkundër mbrojtjes Kushtetuese dhe ligjore që kanë dhe pozita e tyre do të avancohet vetëm brenda kornizës së procesit të anëtarësimit në BE – që aktualisht nuk po i ofrohet Kosovës. Për dallim prej tyre, komuniteti turk nuk ka çështje të pazgjidhura, dhe nën kujdesin e Turqisë, statusi i tyre është stabil dhe në avancim e sipër.

## VERIU

Realisht nuk ka pasur përpjekje serioze për zbatimin e PGJS-së në veri as nga hisedarët ndërkombëtarë në Kosovë e as nga QeK.<sup>22</sup> Vendimi për të mbyllur ZCN-në pa e bërë asnjë hap serioz për integrimin e veriut është edhe një shenjë tjetër e punës së pakryer që shënon mungesën e përkushtimit nga sponsorët e pavarësisë për stabilitetin e Kosovës në të ardhmen. Në të vërtetë, GDN-ja do ta lë veriun te dialogu i ardhshëm politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që do të lehtësohet sërish nga BE-ja. Statusi special për veriun tashmë po qarkullon në Bruksel si konsensusi potencial për klubin e 27 shteteve.

Për dallim nga deklarata e janarit të 2012-ës të GDN-së e cila i pat bërë thirrje Serbisë që të tërheq policinë dhe shërbimet shtetërore të sigurisë nga veri i Kosovës, ky përkushtim nuk është përsëritur në deklaratën e saj të qershorit. Në vend të kësaj, QeK është lavdëruar për hapjen e ZAMV-së, e cila duke qenë një hap i pamjaftueshëm në vete dhe me probabilitet të lartë për dështim, vetëm se do ta trasoj rrugën që Kosova ta justifikoj para publikut dialogun politik me Serbinë në lidhje me veriun. Themelimi i ZAMV-së nuk ka prodhuar asgjë

<sup>22</sup> Për më shumë informata, shih: Shpend Kursani, “Vizioni gjithëpërfshirës për veriun: Mundësia e Fundit”, KIPRED (2012). <http://tinyurl.com/c6wd8mk>.

por vetëm një zyrë lokale e cila në mes tjerash, mbështet institucionet paralele të Serbisë në veri; një vazhdimësi e thjeshtë e Zyrës së UNMIK-ut në Mitrovicë (UAM). Udhëheqësja e sapoemëruar e kësaj Zyreje është rekomanduar nga zyrtarët e lartë të BE-së në Kosovë që financiarisht të ndihmoj aktivitetet e komunës paralele të Mitrovicës së Veriut.

Pa një trysni serioze mbi Serbinë për tërheqjen e aparatit të saj të sigurisë nga veriu, dhe me një BE të ndarë rreth statusit të Kosovës, vendimi për mbylljen e ZCN-së është i nxituar. Këto rrethana e lënë shtetin të ndarë përbrenda në prag të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur dhe me shumë sfida përpara me të cilat klasa politike nuk është e aftë për tu përballur.

## **TELASHET ME GJYSMË- LEGJITIMITETIN NDËRKOMBËTAR**

Duke e ditur që PGJS-ja nuk është miratuar nga Rusia dhe Kina, si anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ky dokument nuk u kthye në një propozim të pranuar ndërkombëtarisht për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Kjo çoi deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës në koordinim me SHBA-të dhe vendet anëtare kyçe të BE-së, dhe adoptimi i PGJS-së si platformë për shtet ndërtim dhe funksionimin e tij. Kjo është bërë me mbështetjen vendimtare të sponsorëve të pavarësisë, të cilët fillimisht patën garantuar 100 njohje “të lehta”. Edhe pas më shumë se katër vitesh të pavarësisë së saj, Kosova ka telashe me njohjet, të cilat për një kohë të gjatë kanë mbetur në shifrën prej rreth 90 sosh.

Përballë këtij sfondi, Kosova do të ndihmohej nga ZCN-ja dhe GDN-ja në kërkimin e përfaqësimit në organizatat ndërkombëtare. Me përfshirjen dhe mbështetjen e këtyre dy trupave, Kosova ka arritur që të bëhet anëtare e vetëm dy organizatave ndërkombëtare, e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore. Anëtarësimi dhe përfaqësimi në organizatat tjera të rëndësishme ndërkombëtare sikurse që janë NATO-ja, BE-ja, OKB-ja, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli i Evropës – të rëndësishme për fuqizimin e

legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës – mbetet ende prapa. Premtimi, që daton tash e një vjet më parë, se Kosova do të bëhet anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) madje edhe pasi Këshilli i BE-së e ka pranuar<sup>23</sup> qartazi një fakt të tillë, është shembull i zymtë i paaftësisë së partnerëve perëndimorë për të përmbushur në mënyrë efektive premtimet e tilla. Si pasojë, Prishtina mbetet pa perspektivë realiste për të siguruar anëtarësim në organizatat ndërkombëtare.

Dështimi për fuqizimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës përmes rritjes së numrit të njohjeve është përkthyer gjithashtu në një dështim “të brendshëm” për ta bërë këtë. Deri më sot, pesë vendet anëtare të BE-së nuk e kanë njohur Kosovën, një qëndrim ky që nuk duket se do të ndryshoj shpejtë. Në dritën e paaftësisë për ta ndihmuar Kosovën në këtë drejtim, sponsorët e saj ndërkombëtarë dhe mbikëqyrësit do ta shtyjnë Prishtinën për të hyrë në një dialog politik me Beogradin. Ata presin që ky dialog, që me gjasë do të lehtësohet nga BE-ja dhe e cila është e ndarë sa i përket statusit të Kosovës, do të rezultojë me “normalizimin” e marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Duke marrë parasysh rezultatet e Brukselit gjatë dialogut teknik, është pak e besueshme se dialogu i ri politik do të prodhojë rezultate pozitive brenda kornizës së pritur kohore – kah mesi i 2013-ës.

Në përgjithësi dialogu teknik është karakterizuar me rritje të tensioneve ndërmjet dy shteteve. Përderisa Kosova është lavdëruar për “qasjen konstruktive” të saj, Serbia ka pasur qasje zero-zero<sup>24</sup> në dialog, duke e përdorur atë për interesat e veta derisa në të njëjtën kohë ka punuar kundër legjitimitetit ndërkombëtar të

<sup>23</sup> Këshilli i BE-së, Konkluzionet e Këshillit mbi zgjerimin dhe procesin e stabilizim-asociimit, (Bruksel: 2011). <http://tinyurl.com/c2sbfzr>.

<sup>24</sup> Para fillimit të dialogut, Serbia ka informuar shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën se ata nuk duhet të nxitonë dhe të njohin Kosovën, pasi pretendohet se statusi përfundimtar i Kosovës ende duhet të përcaktohet si rezultat i këtyre negociatave. Kjo është pikërisht ajo që ka ndodhur. Që kur Kosova ka hyrë në dialog, shumë pak progres është bërë në rritjen e numrit të njohjeve.



Kosovës. Zhytja e Prishtinës në këtë dialog në përgjithësi, e ka lidhur të ardhmen e legjitimitetit ndërkombëtar të Kosovës me vullnetin e Beogradit. Për shembull, anëtarësimi në organizatat rajonale ka qenë njëra prej gjërave që është synuar të zgjidhet përmes këtij dialogu. E etur për të fituar legjitimitet në organizatat rajonale, Prishtina përfundoi me pranimin e fusnotës kundërthënëse në emrin e vet kur përfaqësohet në organizatat dhe takimet rajonale. Republika e Kosovës u bë që të përfaqësohet në organizatat rajonale si Kosova\* *(ky emërtim është pa paragjykim për pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 të KS të OKB-së dhe me Mendimin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës).*

Madje edhe ky emërtim i vet-kontestimit të statusit nuk i ka siguruar Kosovës anëtarësim në organizatat rajonale. Kjo marrëveshje ka qenë një trik diplomatik i përdorur nga Brukseli për t'i siguruar Serbisë statusin e kandidatit dhe për të ndihmuar ish-presidentin Boris Tadiq. Beogradit dhe Prishtinës i janë dhënë interpretime të ndryshme për zbatimin e marrëveshjes së yllit. Beogradit i është thënë se në çdo organizatë rajonale, Kosova do të përfaqësohej me të dyja, yllin dhe fusnotën. Prishtinës në anën tjetër i është thënë se do të përfaqësohej vetëm me yll, derisa fusnota do të përmendej vetëm në dokumentet e shkruara. Organizatat rajonale në anën tjetër kanë pranuar “konkluzionin” e

Brukselit pa udhëzime të mëtutjeshme për mënyrën e zbatimit të tij, duke e lënë të hapur për interpretim nga të gjitha palët. Sidoqoftë, Kosova – me ose pa yll dhe fusnotë – ende nuk po mundet që të arrijë anëtarësimin në shumicën e organizatave rajonale.

Më me rëndësi, Bashkimi Evropian nuk e ka gjetur një mënyrë se si të përfshijë Kosovën në agjendën evropiane të anëtarësimit, për shkak të mos njohjes nga pesë vendet anëtare. BE-ja nuk mund të nënshkruaj marrëveshje kontraktuale me jo-shtetet dhe i duhet konsensusi i të gjitha vendeve anëtare për të vazhduar me nënshkrimin e marrëveshjeve kontraktuale. Duke mos qenë në gjendje që të bind anëtarët e vet për njohjen e Kosovës, BE-ja nuk mund të përdor në tërësi levat e veta mbi Prishtinën. Në këtë mënyrë, Kosova është e vendosur në një pozicion për të kërkuar normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, duke shpresuar se kjo “marrëdhënie e re” do të çojë vendet mos-njohëse të BE-së drejt ndryshimit të qëndrimit të tyre kundruall statusit të Kosovës, e që do të rezultonte me më shumë njohje globale dhe përfundimisht me anëtarësim në OKB dhe në organizatat tjera relevante ndërkombëtare. Mirëpo, mësimet e nxjerra nga pozita e Serbisë ndaj dhe sipërmarrjet e saja kundër Kosovës gjatë dialogut të fundit teknik nuk lënë shumë vend që shpresat e tilla të materializohen.

---

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

E drejta autoriale © 2012 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) apo +381 38 227 778.

Ky projekt është mbështetur nga: Balkan Trust for Democracy (BTD)

**B | T | D** The Balkan Trust for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si qëndrime të BTD-së.

---